

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT

V E N D I M

Nr. 1 Datë 20.02.1997

PËR

MIRATIMIN E NDËRTIMIT TË HIDROCENTRALIT TË KALIVAÇIT NË
GRYKËN E KALIVAÇIT MBI LUMIN VJOSË

Me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike, Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Këshilli Kombëtar i Ujit,

V E N D O S I :

1. Të miratojë ndërtimin e hidrocentralit të Kalivaçit, hidrocentral i radhës së parë, më i favorshëm në skemën e shfrytëzimit hidroenergjetik të pjesës poshtë kuotës 110 m të lumit Vjosë.

2. Hidrocentrali i Kalivaçit të ndërtohet në grykën e Kalivaçit me këto parametra kryesorë:

- | | |
|-------------------------------------|-------------------------|
| - Prurja mesatare shumëvjeçare | 150 m ³ /sek |
| - Rënia bruto | 40-45 m |
| - Prodhimi mesatar | (350-370) mln kwh |
| - Niveli maksimal i jashtëzakonshëm | 112 m |

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT KOMBËTAR TË UJIT

ALEKSANDËR MEKSI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT

V E N D I M

Nr. 2 Datë 20.02.1997

PËR

KRYERJEN E STUDIMEVE TË MËTEJSHME TË SKEMAVE HIDROENERGJETIKE
TË LUMENJVE TË SHQIPËRISË

Pasi shqyrtoi propozimin e Ministrisë së Punëve Publike,
Rregullimit të Territorit dhe Turizmit për ndërtimin e hidrocentralit
të Kalivaçit në lumin Vjosë, Këshilli Kombëtar i Ujit,

V E N D O S I :

Ministria e Punëve Publike, Rregullimit të Territorit
dhe e Turizmit, brenda muajit mars 1997 të paraqesë në Këshillin
Kombëtar të Ujit kërkesat për studime të mëtejshme të skemave hidro
energjetike prioritare të lumenjve të Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT KOMBËTAR TË UJIT

ALEKSANDËR MEKSI

